



Datë: 30.10.2025
Numër Protokolli: 537/2026

A.nr.2027/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave i përbërë nga: Eshref Shabani- kryetar Ardita Haxhnikaj-Demi dhe Malsore Gashi Bajraktari -anëtarë, me Ilire Mehmeti-Shaqiri, në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.2027/2025 të datës 15.12.2025 të parashtruar nga ankuesi V.A,kundër organit të punësimit/Ministria e Punëve të Jashtme me Diasporës, në çështjen juridike “*Kërkesë nga marrëdhënia e punës*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 dhe 1.4 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 30.01.2025, mori këtë:

V E N D I M

I. Aprovohet si e bazuar ankesa me numër A.nr.2027/2025 e datës 15.12.2025, e parashtruar nga ankuesi V.A, **detyrohet** Njësia e Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, që të bëjë shqyrtimin e kërkesës së datës 09.10.2025, të parashtruar nga ankuesi i lartshënuar, dhe të nxjerr aktin administrativ në pajtim me legjislacionin në fuqi, brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimi të këtij vendimi.

II. Obligohet Menaxheri i Personelit në Ministrinë e Punëve të Jashtme, të bëjë zbatimin e këtij vendimi brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimi të këtij vendimi, ashtu që të rishqyrtoj dhe vendos për kërkesën e palës ankuese dhe të nxjerr aktin administrativ në pajtim me legjislacionin në fuqi duke marr për bazë pikëpamjet e dhëna juridike si në këtë vendim.

III. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Nëpunësi civil V.A(*tutje referuar ankuesja*), më datë 15.12.2025, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, lidhur me heshtjen administrative për mos njohën e përvojës së punës nga organi i punësimit.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (*tutje referuar Këshilli*) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 19.12.2025, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë te Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, ndërsa, kjo e fundit më datë 13.01.2026, ka dorëzuar shkresat lidhur me çështjen në procedurë.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave tutje referuar Kolegji i Këshillit, **ka administruar këto prova:** Ankesën me numër protokolli 7895/2025 të datës 15.12.2025 të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Kërkesën me numër 3684 të datës 09.10.2025; Dokumentin e identifikimit të ankuesit; Deklaratën nën betim të datës 09.10.2025; Certifikatën me numër 386 të datës 27.12.2016; Përgjigjen me numër protokolli 338/2024 të datës 23.10.2024; Certifikatën e datës 31.10.2023; Kontratën për rezilizimin e shërbimeve të përkthimit të datës 03.03.2021; Referencën e datës 15.06.2023; Vërtetimin e datës lidhur me kryerjen e punës si komisionar në zgjedhjet lokale për periudhën kohore 01.10.2017 deri me 30.11.2017; Pasqyrën e llogaris Trustit të datës 20.11.2017-09.10.2024; Akt emërimit të datës 03.04.2025; Pasqyrën e llogarisë Trustit të datës 20.11.2017-02.10.2025; Përgjigjen në ankesë të datës 13.01.2026; Përgjigjen me numër protokolli 37997 të datës 17.10.2025.

Kolegji i Këshillit, pasi që ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës, ka konstatuar se meqenëse nuk është nxjerr akt administrativ lidhur me kërkesën e ankueses, atëherë ekziston baza ligjore që të detyrohet Njësia e Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, të nxjerr aktin administrativ në pajtim me legjislacionin në fuqi lidhur me shqyrtimin e kërkesës të datës 09.10.2025, parashtruar nga ankuesi, **sepse:**

Nga administrimi i provave materiale të lëndës rrjedhë se ankuesi, sipas Akt Emërimit Nr.281/2025 të datës 01.04.2025, është e punësuar në pozitën e punës *Zyrtar për Shërbime të Jashtme*, në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës.

Si rrjedhojë, ankuesi sipas Deklaratës nën betim të nënshkruar me datë 09.10.2025 i njëjti ka deklaruar se: *Nga data 05.01.2016 deri me datën 27.12.2017 ka kryer punën praktike profesionale një vjeçare në Institucionin Publik “Gjykata Themelore në Gjilan”, të cilën e dëshmon përmes vërtetimit të datës 27.12.2016 se Certifikatës së datës 23.10.2024 nga data 01.10.2017 deri me datën 30.11.2017 ka punuar si komisioner në zgjedhjet lokale të cilën e dëshmon vërtetimin si dhe pasqyrën e llogarisë së Trustit. nga data 03.03.2021 deri me datën 03.03.2025 ka punuar në kompaninë e përkthimeve “Prestige” ku si dëshmi ka sjell referencën dhe kontratën e punës si përkthyes dhe interpret gjuhësore. Nga data 01.04.2025 ku ende ankuesi vazhdon të punoj në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës.*

Tutje, me datë 09.10.2025 ankuesi ka parashtruar kërkesë Njesisë së Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, me qëllim të njohjes së përvojës së punës profesionale si përvojë pune në sektorin privat dhe publik, që e njëjta të figurojë në dosjen personale të ankuesit. Udhëheqësi i Njesisë së Burimeve përmes përgjigjes së datës 17.10.2025 i cili pas shqyrtimit të kërkesës së ankuesit lidhur me përvojën e punës, ka konstatuar se përvoja e punës së ankuesit nuk është komform kushteve dhe kriterëve të përcaktuar me Rregulloren (QRK) NR.05/2023 për Pagën Bazë dhe Përvojën e Punës për të Punësuarit në Sektorin Publik, andaj dhe nuk mund të njihet për efekt të llogaritjes së përvojës në pune.

Ankuesi, në ankesën e parashtruar në Këshill, pretendon se me rastin e parashtrimi të kërkesës pranë Njesisë së Burimeve Njerëzore për njohjen e përvojës së punës të njëjtit nuk kanë ndërmarr asnjë veprim duke mos nxjerr akt administrativ lidhur me njohjen e përvojës së punës.

Në kuptim të shqyrtimit të pretendimeve ankimore të ankuesit dhe konstatimit të ligjshmërisë së aktit të kontestuar nga ankuesi, Kolegji i Këshillit ka analizuar dispozitat ligjore të Rregullores (QRK) Nr.05/2023 për Pagën Bazë dhe Përvojën në Punë për të Punësuarit në Sektorin Publik, e zbatueshme nga data 6 qershor 2023, me theks të veçantë nën paragraf 2.2, më të cilin është përcaktuar se: 2. *Përvoja e punës dëshmohet përmes njëres prej dëshmive si vijon: “2.2. **pas qershorit 1999:** 2.2.1. dëshminë mbi përvojën e punës të lëshuar nga njësia kompetente për menaxhimin e personelit në Institucionet e Republikës së Kosovës ose nga misioni i Kombeve të Bashkuara në Kosovë; 2.2.2. dëshminë mbi përvojën e punës të lëshuar nga ndërmarrjet publike ose nga ndërmarrjet shoqërore të cilat kanë qenë ose janë nën administrimin e Agjencisë Kosovare për Privatizim; 2.2.3. dëshminë për kryerjen e obligimeve mbi të ardhurat personale për punëtorin; 2.2.4. dëshminë mbi pagesën e kontributeve pensionale pranë organit kompetent; 2.2.5. dëshmisë së përkthyer mbi përvojën e punës së lëshuar nga organi kompetent i një shteti të huaj në të cilin punëtori ka punuar; 2.2.6. çdo dëshmi tjetër të vërtetuar në procedurë gjyqësore përmes aktgjykimit të plotfuqishëm; 2.2.7. dëshmi tjetër plotësuese mund të konsiderohet edhe lista e pagave.”*

Kolegji i Këshillit, bazuar në dispozitat e lartë theksuara ligjore dhe shkresat e bashkangjitura të lëndës, ka gjetur se ankuesi ndërlidhur me pretendimet e tij për njohjen e përvojës së punës, ka bashkangjitur këto dëshmi: si certifikatat, vërtetimet, kontratën e punës, dhe pasqyrën e trustit. Andaj Kolegji i Këshillit, erdhi në përfundim se organi përkatës i punësimit nuk ka vërtetuar drejtë dhe në plotësi gjendjen faktike, konkretisht nuk ka llogaritur saktë apo fare përvojën e punës të punës së ankuesit, duke i dhënë vetëm një përgjigje për të cilën nuk ka specifikuar saktësisht se cili nen e përcakton që përvoja e punës së ankuesit nuk është komfort kushteve dhe kriterëve të përcaktuara në këtë rregullore. Andaj edhe pretendimet ankimore të ankueses gjejnë mbështetje në kërkesat ligjore të nenin 6 paragrafi 2 nën paragrafit 2.2 të Rregullores (QRK) Nr.05/2023 për Pagën Bazë dhe Përvojën në Punë për të Punësuarit në Sektorin Publik.

Tutje, Kolegji i Këshillit në vështrim të gjeturave dhe konstatimeve të dhëna si më lartë, analizoi edhe dispozitat e nenit 47 paragrafin 1 nën paragrafi 1.1, 1.2 dhe 1.3 dhe nënti 48 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative ku përcaktohet se: “1. Akti administrativ i shkruar përmban: 1.1. pjesën hyrëse, që tregon emrin e organit publik që ka nxjerrë aktin, bazën ligjore, emrin e atij të cilit i drejtohet akti, shënim të shkurtër të lëndës së procedurës dhe datën e nxjerrjes; 1.2. pjesën urdhëruese (dispozitivin), që tregon çfarë është vendosur si dhe afatin, kushtin, detyrimin dhe shpenzimet e procedurës, nëse është i zbatueshëm. Dispozitivi mund të ndahet edhe në më shumë pika. Shpenzimet e procedurës përcaktohen në pikë të veçantë të dispozitivit. 1.3. pjesën arsyetuese (në vijim: arsyetimin); 48.1. Arsyetimi i siguron palës mundësinë që ta kuptojë aktin administrativ. Arsyetimi përmban: 1.1. paraqitje të shkurtër të kërkesës së palës; 1.2. shpjegimin e situatës faktike mbi të cilën është marrë vendimi; 1.3. shkaqet të cilat kanë qenë vendimtare gjatë vlerësimit të provave; 1.4. bazën ligjore të vendimit dhe arsyen pse është e zbatueshme në rastin konkret; 1.5. shkaqet për të cilat nuk është pranuar ndonjëri nga pretendimet e palëve; 1.6. në rastin e ushtrimit të diskrecionit, shpjegimin pse është ushtruar ai në mënyrën e dhënë në vendim.” dhe mbi këtë bazë Kolegji i Këshillit konstatoi se përgjigja e datës 17.10.2025 e Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, nuk e zëvendëson aktin administrativ, andaj duhet të veprohet sikur në dispozitat e lartshënuara

Kolegji i Këshillit, duke u bazuar në kuadrin ligjor të cekur si më lartë, lidhur me obligimin e organit përkatës për të vendosur lidhur me kërkesën e palës, e obligon Njësia e Burimeve Njerëzore, respektivisht Menaxheri i Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, që të nxjerr aktin administrativ në pajtim me legjislacionin në fuqi lidhur me shqyrtimin e kërkesës të parashtruara nga pala ankuese të përfshira në këtë vendim, në atë mënyrë që gjatë shqyrtimit të kërkesës të shqyrtohen të gjitha pretendimet e palës ankueses dhe të vendoset për të gjitha pretendimet në fjalë në kuptim të nenit 48 paragrafi 1 ndërlidhur me nenin 134 paragrafi 1 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar nenin 6 paragrafi 1, nën paragrafi 1.1 dhe nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 dhe 1.4 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-180, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda, A.nr.2027/2025

Ilire Mehmeti-Shaqiri

Procesmbajtëse

Eshref Shabani

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit V.A;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës ; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.